

Gëzim Alpion

Gëzim Alpion u lind në Peshkopi në vitin 1962. Pasi ndoqi studimet për BA dhe MA në Universitetin i Kajros, Egjipt (1995-1993), mbrojti doktoratën në Universitetin e Durham-it në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1997.

Ai ishte pedagog në Universitetet e Huddersfield, Sheffield Hallam dhe Newman në Angli përpara emërimit në vitin 2002 në Departamentin e Sociologjisë në Universitetin e Birmingham-it. Ai u bë *Honorary Fellow* i Institutit për Kërkime të Avancuara në Arte dhe Shkencat Sociale në vitin 2000, *Senior Fellow* i Akademisë së Arsimit të Lartë në vitin 2022 dhe u zgjodh Anëtar i Jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në vitin 2024. Aktualisht është Profesor i Asociuar i Sociologjisë në Birmingham.

Veprat e Alpion përfshijnë: *Vouchers: A Tragedy* (2001), *Foreigner Complex: Essays and Fiction about Egypt* (2002), *Mother Teresa: Saint or Celebrity?* (Routledge 2007), *If Only the Dead Could Listen* (Globic Press 2008), *Encounters with Civilizations: From Alexander the Great to Mother Teresa* (Routledge 2017), dhe *Mother Teresa: The Saint and Her Nation* (Bloomsbury Academic 2020), fitues i Çmimit të Ekselencës akorduar nga Asocioni i Botuesve Katolikë (ACP) në SHBA në kategorinë e biografisë për vitin 2023. Monografia e tij *Madre Teresa: Santa o Celebrità?* u botua në Romë nga Salerno Editrice në 2008.

Alpion konsiderohet nga kritika si 'autori më autoritar në gjuhën angleze' për Shën Terezën e Kalkutës dhe 'themeluesi i Studimeve për Nënë Terezës'. Për librat e tij janë botuar mbi 120 recensa pozitive në revista shkencore të botuesve të mirënjohur akademikë si *Oxford University Press*, *Routledge* dhe *Brill*, si dhe në gazeta, revista dhe portale të ndryshme të njohura në mbarë botën.

Alpion është autor i disa kapitujve mbi tema rreth sociologjisë së fesë, nacionalizmit dhe medias në vëllime të botuara nga botues si *Sage*, *University Press of America* dhe *Brewin*. Ai, gjithashtu, ka kontribuar pesëmbëdhjetë studime dhe artikuj në revista akademike të botuara nga *Routledge*, *Sage*, *Palgrave*, *Brill*, *Wiley-Blackwell*, *London School of Economics and Political Science* (LSE), *Johns Hopkins University Press* dhe *Universiti i Nottinghamit* : *Islam and Christian-Muslim Relations*; *Celebrity Studies*; *Continuum: Journal of Media & Cultural Studies*; *The Review of Communication*; *Journal of Southern Europe and the Balkans* (now *Journal of Balkan and Near Eastern Studies*); *International Journal of Public Theology*; *Studies in Religion/Sciences Religieuses*; *Critical Research on Religion*; *Scope: Journal of Film Studies*; *The Journal of the Royal Anthropological Institute*; *Film & History: An Interdisciplinary Journal of Film and Television Studies*; *Nations and Nationalism*; dhe *Filmbuff – An International Film Journal*.

Alpion ka shqyrtuar propozime librash për botues akademikë si *Palgrave Macmillan*, *Pearson Education*, *Polity Press*, *Sage* dhe *Routledge*; dhe artikuj për revista shkencore si *Celebrity Studies*; *Islam and Christian-Muslim Relations*; *Immigrants & Minorities: Historical Studies in Ethnicity, Migration and Diaspora*; *British Politics*; *International Journal of Public Theology*; *Cultural Sociology*; *European Journal of Social Theory*; dhe *International Journal of Cultural Studies*.

Alpion ka ekzaminuar punime doktoraturash për universitete të njohura në Indi; Programin e Sociologjisë të Universitetit York St John në Angli; si dhe një Program të Studimeve Sociale për Komisionin e Arsimit të Lartë të Republikës së Maltës. Alpion është anëtar bordi i disa revistave shkencore, përfshirë *Celebrity Studies* (Routledge).

Sponsorizuar nga Këshilli i Arteve të Anglisë, dramat e Alpion – *Vouchers: A Tragedy* dhe *If Only the Dead Could Listen* – që përqendrohen në trajtimin e azil-kërkuesve dhe refugjatëve në Mbretërinë e Bashkuar, u pritën mirë nga kritika, spektatorët dhe mediat kur u vunë në skenë në disa qytete në Angli në 2002, 2006 dhe 2008. Dramat u botuan në Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA në 2001 dhe 2008, respektivisht. Sipas mediave britanike, shtjellimi i temës së emigracionit në dramat e Alpion ‘përbën një kontribut në debatin për trajtimin e refugjatëve në Evropën Perëndimore’.

Artikujt e Alpion mbi politikën, kulturën dhe identitetin në kontekstin britanik, ballkanik, indian dhe të Lindjes së Mesme janë botuar në disa gazeta, revista dhe portale të njohura ndërkombëtare si *The Guardian*, *The Independent*, *The Tablet*, *The Conversation* (Londër), *Hindustan Times* (New Delhi), *The Middle East Times* (Kairo), *The Hürriyet Daily News* (Stamboll), dhe *Mercator* (Sydney). Ai është intervistuar, profilizuar dhe cituar nga agjenci lajmesh, rrjete televizive, gazeta dhe revista në mbi 30 vende.

Vitet e fundit, Alpion është ftuar të zhvilloj mbi 70 leksione në konferenca ndërkombëtare dhe universitete të njohura në 15 vende, duke përfshirë Universitetet e Kajros, Kembrixhit, Delhi, Georgetown (Uashington, D.C.), Harvard, Helsinki, IIT Madras (Chennai), London School of Economics, McGill (Montreal), Melburn, Moskë, Nju Jork, Oksford, Shanghai, Witwatersrand (Johannesburg), Universiteti Kombëtar i Singaporit dhe Universitë Pontificia Salesiana (Romë).

Botimet dhe aktiviteti akademike i Alpion janë përcjellë nga 130 media në më shumë se 25 vende në po aq gjuhë. Shkruar nga ish-redaktori i fesë i Revistës *Time*, një artikull mbi hulumtimet e Alpion rreth Nënë Terezës u botua në Revistën *Life* në Nju Jork në vitin 2022.

Alpion ka kontribuar edhe për shoqërinë civile. Në mars 2013, ai filloi një peticion online nëpërmjet, të cilit i kërkohet qeverisë shqiptare të përfundojë ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Në vitin 2014, Alpion filloi lobimin për shenjtërimin e Nënë Terezës, e cila u kanonizua në vitin 2016.

Alpioni është vlerësuar nga shteti shqiptar për hulumtimet e tij serioze rreth personalitetit dhe veprës së Nënë Terezës si dhe për kontributin e tij për shoqërinë civile. Ai u nderua me titullin ‘Ambasador i Kombit’ nga Kryeministri i Shqipërisë në vitin 2019 dhe çmimin ‘Nënë Tereza’ nga Presidenti i Shqipërisë në vitin 2021.

Dr. Alpion dhe bashkëshortja e tij znj. Dashi Alpion, Këshilltare e Karrierës në Universitetin e Birminghamit, kanë dy fëmijë dhe banojnë në Birmingham.